



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2510/2 prot.,

Datë 14.11.2022

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-44358-10-04-2022, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, shkolla e kopshte, çerdhe”, me fond limit 4,992,574 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.
- Ankimues:** “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK  
*Adresa: Rruga e Durrësit, Hyrja nr.3, pasuria e llojit bodrum, nr. 4/12+3-B/1, zonë kadastrale 8210*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vorë  
*Rr. “Unaza”, Vorë*

Në datën 14.11.2022 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2022/2681 dhe numër protokoll nr. 2510 prot., datë 14.11.2022 e operatorit ekonomik “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-44358-10-04-2022, me objekt: “Shpenzime për mirëmbajtje e objekteve ndërtimore, shkolla e kopshte, çerdhe”, me fond limit 4,992,574 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vorë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE” SHPK kundërshton me anë të ankesës me numër elektronik A/2022/2681 datë 14.11.2022 dhe nr. 2510 prot., datë 14.11.2022 .

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

**Arsyet e skualifikimit:**

*Oferta refuzohet pasi nuk është përmbushur pika 2.3.5 germa b e kriterëve të veçanta të kualifikimit. Mjetet e paraqitura me kontrata qeraje rezultojnë për përdorim vetjak dhe jo për përdorim ndaj të tretëve sipas kriterit të vendosur nga AK si dhe shkresës Nr. 4916/2 Prot., datë 14.07.2022 me lëndë “Sjellje në Vëmëndje” të Agjencisë së Prokurimit Publik, Kreu II, pika 5 ku thuhet: “Mjetet e marra me qira nuk duhet të rezultojnë për përdorim vetjak, por në përdorim nga të tretët”.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 14.11.2022.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**